



**NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE PËR STAF ADMINISTRATIV**

**Pozicioni:** Specialist i Zyrës së Marketingut

**Fusha specifike:** Te ndryshme

**Tipologjia:** Me kohë të plotë

**Data e fillimit:** Tetor 2021

**Afati i aplikimit:** 06.10.2021

Universiteti Metropolitan Tirana është një universitet i çertifikuar nga MASR i përbërë nga tre fakultete, Inxhinieri e Ndërtimit dhe Arkitekturës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT. Numri i përgjithshëm i studentëve në UMT është rreth 1000, numër i cili ka pësuar një rritje të ndjeshme në dy vitet e fundit.

I klasifikuar si një nga universitetet më të mirë në Shqipëri, një rëndësi të veçantë i është dhënë kohët e fundit krijimit të një ekosistemi ndërmarrjesh, inovacionit pedagogjik si dhe strukturimit të aktiviteteve shkencore rreth shkollave të doktoraturës në bashkëpunim me institucione dhe kolegë nga Evropa dhe USA. Një rëndësi të veçantë i është dhënë internacionalizimit të aktiviteteve pedagogjike nëpërmjet një sërë marrëveshje me universitete evropiane dhe projektet Erasmus në mbështetje të mobilitetit të studentëve. Gjithashtu po i jepet një rëndësi e veçantë nënshkrimit të marrëveshjeve me ndërmarrjet evropiane dhe vendase për mbështetjen e aktivitetit pedagogjik dhe shkencor si dhe punësimin e studentëve të UMT.

**Universiteti Metropolitan Tirana**

**rekruton për pozicionin Specialist i Zyrës së Marketingut**

Ju jeni mbajtës i diplomës të nivelit “Master i Shkencave” ose ekuivalente me të (DIND), jeni njohës i të paktën një gjuhe të huaj dhe zotëroni gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur, nuk jeni dënues me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një veprë penale dhe keni vlerësime pozitive të përvojave të mëparshme të punës.

Ju zotëroni aftësitë e nevojshme profesionale, keni eksperiencë pune në fushën e marketingut dhe për me teper keni njohuri në fushën e edukimit universitar, gjithashtu shfaqni aftësi organizative dhe bashkëpunimi në grup atëherë ju jeni kandidati i duhur për pozicionin e lirë të punës si specialist i Zyrës së Marketingut.

**Mënyra e vlerësimit:**

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

**Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive mbi të cilat do të zhvillohet intervista:**

Diploma ose kualifikimi pasuniversitar në fusha të tilla si komunikim, marketing, ekonomi, biznes ose statistikë mund të jetë e dobishme dhe e preferuar.

Në intervistë, kandidatët do të vlerësohen për njohuritë, aftësitë, kompetencat, eksperiencën e tyre të mëparshme, motivimin, aspiratat si dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.



Përshkrimi i punës:

- mbikqyrjen dhe zhvillimin e fushatave të marketingut
- kryerjen e kërkimit dhe analizimin e të dhënave për të identifikuar dhe përcaktuar grupet e interesit
- krijimi dhe paraqitja e ideve, strategjive, si në komunikim dhe në marketing si edhe planet e veprimit
- organizimi i aktiviteteve promovuese
- përpilimi dhe shpërndarjen e informacionit financiar dhe statistikor
- shkrimi dhe korrigjimi i materialeve krijuese
- mirëmbajtja e faqeve të internetit dhe përditësim dhe analizë të të dhënave
- organizimi i eventeve
- përditësimi të dhënash dhe përdorimi i një sistemi të menaxhimit të marrëdhënieve
- koordinimi i marketingut të brendshëm dhe kulturës së institucionet
- monitorimin e performancës
- menaxhimin e fushatave në mediat sociale.

Për çdo paqartësi mund të dërgohet email në adresën [humanresources@umt.edu.al](mailto:humanresources@umt.edu.al).

Kandidatët konkurrentë duhet të dërgojnë në format elektronik këtë dokumentacion:

- Kërkesë me shkrim.
- CV ( Curriculum Vitae)
- Referenca
- Kopje e diplomës dhe listës së notave të nivelit “Master i Shkencave” Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e noterizuar e çertifikatës së njohjes nga organi kompetent (MASR), ose vërtetim që janë në proçes njohje.

**Aplikimet duhet të dorëzohen me e-mail në [humanresources@umt.edu.al](mailto:humanresources@umt.edu.al)**